



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 46 Datë 03/09/2025

“ Për dhënie Titull Nderi”

Mbështetur në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma m, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, paraqitet në mbledhjen e Këshillit, propozimi për Tituj Nderi. Këshilli Bashkiak shqyrtoi propozimin dhe në mbledhjen e tij, me datë 03.09.2025 me 17 vota pro, 0 kundër dhe 3 apstenim.

VENDOSI

1. Për dhënien e titullit **Qytetar Nderi** (pas vdekjes) për:

Znj. Violeta Ramadan Alia(Elezi)

Me motivacion:

“ Për kontributin e jashtëzakonshëm në mjekësinë veterinare, edukimin dhe kërkimin shkencor, si dhe për përkushtimin e saj ndaj komunitetit dhe qytetit të Peshkopisë. Puna e saj si përgjegjëse e Zyrës Veterinare në Peshkopi dhe si pedagoge në Universitetin Bujqësor të Tiranës ka pasuruar fushën e veterinarisë dhe ka ngritur standardet e shërbimit publik. Edhe përballë sfidave personale, ajo dha gjithmonë shembull për profesionalizëm, përkushtim dhe dashuri për qytetarët. Ky titull është mirënjohje për jetën dhe veprën e saj, një shembull frymëzimi për brezat e ardhshëm.”

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak

